



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Deçan, dt.23.08.2016

Drejtoria e Arsimit- Deçan

Konform kërkesës së datës 17.08.2016 nga Gjimnazi “Vellëzrit Frashëri” në Deçan si dhe në bazë të planifikimit për regjistrimin e nxënësve në klasat e X-ta nga DKA në Deçan , Drejtorati për arsim në Deçan, shpall :

K O N K U R S

Për regjistrimin e nxënësve në klasat e X-ta në afatin e dytë në arsimin e mesëm të lartë për vitin shkollor 2016 – 2017 në komunën e Deçanit.

I. Gjimnazi “ Vëllezërit Frashëri “ në Deçan

**Drejtimit : Nr. i nxënësve Gjithsej
Shkencat:**

Shk.Natyrore

10 nxënës

Shk.Shoqërore

60 nxënës

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në gjimnazin “Vellëzrit Frashëri” në Deçan për vitin shkollor 2016/17, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnazin “Vellëzrit Frashëri” për vitin
shkollor 2016/2017, bëhet më datën 24, 25 dhe 26 gushtë 2016 në lokalet
e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora
8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollën përkatëse me
datën 29.08.2016

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet
prej 01.09.2016, 05.09.2016

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e
regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së
rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale
të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për
ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

**Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto
kriteret:**

- 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë**
 - 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë**
 - 3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë**
- Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë **100 pikë**.

Drejtori i DKA-së:
z. Qazim Maloku

